



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:135351

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05429397

C.nr.1453/17

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm gjyqtari Shaban Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit për shkak të kompensimit të dëmit më datën 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së paditësit S.S.

Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e paditësit e marrin përsipër procedurën apo kur gjykata të vlerëson ndryshe.

A r s y e t i m

Paditësi S.S. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit për shkak të kompensimit të dëmit.

Gjykata lidhur më këtë çështje sipas shkresës së kolegut Gëzim Shehu drejtuar sektorit të gjendjes civile ka siguruar certifikatën e vdekjes më nr.rendor 92 në bazë të cilës si provë vërtetohet fakti se paditësi ka vdekur më dt.13.12.2023 andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 277 par.1 pika (a) e lidhur më nenin 280 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i pergjithshëm-
C.nr.1453/17, dt. 08.03.2024

Gjyqtari
Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.